

UNIVERSITETI I PRISHTINËS

FAKULTETI I EDUKIMIT



Mimoza Kamberi

**NDIKIMI I MOTIVIMIT NË ARRITJET  
AKADEMIKE PËRMES STRATEGJIVE TË  
TË MËSUARIT DHE KONSUMIMIT  
AKADEMIK**

REZYMEJA E PUNIMIT TË DOKTORATËS

Prishtinë, 2022

## Rezimeja

Aspekt i rëndësishëm dhe pjesë e pashmangshme e arritjeve akademike të studentëve është motivimi akademik (Manganelli et al., 2019; Tella, 2017). Në përgjithësi, motivacioni u referohet faktorëve që i drejtojnë individët të bëjnë apo të mos bëjnë diçka (Broussard & Garrison, 2004). Këta faktorë, të cilët motivojnë sjelljet njerëzore mund të jenë me orientim të jashtëm dhe të brendshëm dhe janë të njohur si motivim intrinzik dhe motivim ekstrinzik (Nushi, 2002). Motivimi intrinzik i referohet sjelljes individuale të drejtuar nga faktorët e brendshëm siç janë: dëshira, interesi apo kënaqësia, ndërsa motivimi ekstrinzik i referohet sjelljes individuale të drejtuar nga faktorët e jashtëm siç janë: shpërblimet materiale, lavdërimet verbale etj. (Deci, 1971). Në vazhdimësi, hulumtuesit kanë gjetur se ngritja e nivelit të motivimit akademik është një faktor themelor dhe kontribuues i rëndësishëm i arritjeve akademike (Tella, 2007; Trevino & DeFreitas, 2014; Uguroglu & Walbert, 1979), prandaj ngritja e nivelit të motivimit akademik është e lidhur me arritje më të lartë akademike (Amrai et al., 2011).

Studime të shumta ekzaminuan ndikimin e llojeve të motivimit siç janë: motivimi intrinzik dhe ekstrinzik në arritjet akademike të studentëve duke parashikuar në mënyrë signifikante notat universitare të studentëve (Ryan & Deci, 2000a; Vecchione et al., 2014).

Në anën tjetër, faktor i rëndësishëm me ndikim në arritje akademike janë edhe strategjitë e të mësuarit. Studentët përdorin herë pas here strategjinë e thellë apo sipërfaqësore për të mësuar (Biggs et al., 2001). Shikuar nga konteksti i teorisë vetë-përcaktuese, kur studentët janë të motivuar intrinzikisht, ata janë më energjikë për të mësuar materialin e ri dhe së këndejmi përdorin strategjinë e thellë të të mësuarit, duke i shkuar në thellësi materialit për ta kuptuar plotësisht dhe kjo do t'u ofrojë atyre ndjenjën e kënaqësisë. Në anën tjetër, studentët e motivuar ekstrinzikisht do të veprojnë në këtë mënyrë vetëm nëse ndonjë shpërblim është i përfshirë, që në rastin e studentëve, nota e marrë do të ishte një shpërblim për ta (Baard et al., 2004).

Një koncept tjetër i rëndësishëm në fushën e edukimit i cili kohëve të fundit është duke u studiuar në raport me arritjet akademike të studentëve është konsumimi akademik, term ky që sipas teorisë multidimensionale të Maslach (1981) paraqet një sindromë psikologjike e përbërë nga tri pjesë: rraskapitja për shkak të kërkesave akademike të fakultetit, cinizmi që ka të bëjë me qëndrimet cinike dhe të shkëputura ndaj obligimeve akademike të fakultetit dhe efikasiteti profesional që paraqet sensin individual mbi efikasitetin gjatë përmbushjes së obligimeve akademike (Maslach & Jackson, 1981; Schaufeli et al., 2002).

Të hedhurit dritë mbi kuptimësinë e ndërlidhjes në mes motivimit dhe arritjeve akademike të studentëve dhe faktorëve që ndikojnë në këtë relacion është mjaft komplekse dhe shumë-dimensionale, prandaj zgjedhja e një kompleksiteti të tillë vazhdon të jetë një sfidë, jo vetëm për hulumtuesit e rinj, por edhe për gjithë korpusin shkencor në përgjithësi. Si rrjedhojë, teori dhe ide të reja lidhur me motivimin dhe arritjet akademike në vazhdimësi promovohen, me ç 'rast studiuesit përpiqen që përmes gjetjeve të tyre shkencore të ofrojnë njohuri mbi rolin e motivimit në arritjet akademike në mënyrë që të përmirësojnë procesin e të mësuarit dhe arritjet akademike të studentëve.

Studimi është kuantitativ dhe ka pasur për qëllim të ekzaminoj ndikimin e motivimit intrinzik, motivimit ekstrinzik në arritje akademike nëpërmjet strategjive të të mësuarit dhe konsumimit akademik. Teoria vetë-përcaktuese është teoria kryesore në këtë studim, kjo teori mbështetet në përmbushjen e tri nevojave bazike psikologjike siç janë: kompetenca, lidhshmëria, autonomia dhe bën dallimet kualitative dhe kuantitative në mes motivimit intrinzik që buron brenda individit dhe motivimit ekstrinzik që rrjedh nga burimet e jashtme. Pjesëmarrës në këtë studim ishin studentët e programeve edukim para fillor dhe edukim fillor në katër fakultetet e edukimit në Republikën e Kosovës. Për të testuar hipotezat e studimit, janë aplikuar analiza të regresionit ku prediktorë ishin motivimi intrinzik dhe motivimi ekstrinzik ndërsa arritja akademike ishte variabla e varur. Për qëllime të studimit janë përdorur analiza ndërmjetësuese. Për të zbatuar këtë analizë motivimi intrinzik dhe ekstrinzik janë paraqitur si prediktorë, arritja akademike si variabël e varur, strategjia e thellë e të mësuarit, strategjia sipërfaqësore e të mësuarit si dhe tri konstruktet e konsumimit akademik siç janë: raskapitja, cinizmi, efikasiteti profesional si variabla ndërmjetësuese. Rezultatet e studimit kanë treguar se motivimi intrinzik dhe motivimi ekstrinzik kanë ndikim pozitiv në arritje akademike si dhe ndikimi i motivimit intrinzik dhe motivimit ekstrinzik në arritje akademike ndërmjetësohet nga strategjia e thellë e të mësuarit, strategjia sipërfaqësore e të mësuarit dhe konstruktet e konsumimi akademik. Studimi në aspekt teorik do të kontribuoj literaturës duke sjellur evidencë shkencore mbi ndërlidhjen mes motivimit intrinzik, motivimit ekstrinzik në arritje akademike nëpërmjet ndërmjetësuesve të lartpërmendur. Gjithashtu në rrafshin praktik në bazë të rezultateve të studimit janë propozuar strategji të ndryshme intervenimi për të përmisuar arritjen akademike të studentëve të edukimit. Këto strategji janë të ndërlidhura me motivimin intrinzik dhe motivimin ekstrinzik në raport me arritjet akademike të studentëve nëpërmjet strategjive të të mësuarit, konsumimit akademik.